

## FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Për të qartësuar një gjë që në fillim: ajo, për të cilën ne nuk ishim dakord dje në Konferencën e Kryetarëve, nuk kishte të bënte me kalendarin e hartuar prej jush, por me dy çështje shumë të rëndësishme të paraqitura prej nesh. Njëra prej të cilave është ajo, e cila tashmë është bërë legjendë në njëfarë mënyre, sepse është e treta ose e katërta herë që ne e kemi paraqitur, pra bëhet fjalë për kërkesën e ngritjes së komisionit hetimor për investimet strategjike.

Është depozituar sipas të gjitha procedurave administrative në administratën e Kuvendit, bashkë me përmbajtjen, përcaktimin e objektit dhe çështjeve, sigurisht, edhe me çështjen e nënshkrimeve, aq sa Rregullorja dhe ligji për komisionet hetimore kërkojnë. Sigurisht, ishte çudi, siç jua shpreha edhe dje, pse nuk është përfshirë në mbledhjen e djeshme të Konferencës së Kryetarëve. Po e them edhe sqarimin që ju e thatë dje, me shpresën që në një afat 5-ditor nga paraqitja e kërkesës, Konferenca e Kryetarëve të mblidhet dhe ta shqyrtojë sipas të gjitha rregullave të Rregullores së këtij Kuvendi. Gjithsesi, kjo ishte një arsye pse nuk ramë dakord dje për çështje të diskutuara në Konferencën e Kryetarëve.

Së dyti, ka të bëjë me kërkesën e paraqitur nga ana jonë për rezolutën për mocion me debat në lidhje me krimin dhe gjenocidin në Kosovë, që është paraqitur që në datën 27 maj. Kjo është një kërkesë e depozituar, sipas të gjitha rregullave. Besoj se nuk ka asnjë lloj shpjegimi arsyeja e mospërfshirjes në rendin e ditës, sepse neni 98 i Rregullores e përcakton në mënyrë të qartë se, kur paraqitet një kërkesë për mocion për debat, duhet që në mbledhjen më të parë, së paku 3 ditë nga momenti i depozitimit, të përfshihet në rendin e ditës dhe për këtë arsye të mblidhet edhe Konferenca e Kryetarëve.

Nuk është mbledhur, sipas afatit, madje edhe dje ju nuk e përfshitë në rendin e ditës rolin e drejtuesit të Konferencës së Kryetarëve. Besoj se kjo është një shkelje, së paku flagrante, e Rregullores. Për këtë arsye këto ishin shkaqet, për të cilat nuk ramë dakord dhe për të cilat duhet që ky Kuvend jo vetëm të tutëlojë, por edhe të mbrojë të drejtat e deputetëve, të

veprimtarisë normale të Kuvendit, të marrë masat për të rikuperuar situatën e rendë të shkaktuar dje në Konferencën e Kryetarëve. Pra, këto ishin arsyet, për të cilën ne nuk ramë dakord. Faleminderit!